



REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVO · REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 maj 2023  
Nr. ref.:RK 2158/23

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**  
në

**rastin nr. KI161/22**

Parashtrues

**Ekrem Breznica**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr.  
70/2022 të 6 majit 2022**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Ekrem Breznica nga fshati Miradi e Epërme, komuna e Fushë Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqësojnë avokatët, Feim Alaj dhe Durim Osmani.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e aktgjykimit [Rev. nr. 70/2022] të 6 majit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me aktgjykimin [A. C. nr. 1139/2018] të 12 janarit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe aktgjykimin [P. nr. C. nr. 1468/13] të 31 majit 2017 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës e pranoi vendimin e kontestuar më 21 korrik 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, përmes të cilit, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 19 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit GjR. KSH. KI161/22 caktoi Gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 31 tetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë kopjen e fletëkthesës me datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 3 nëntor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar me datën e pranimit 21 korrik 2022 të vendimit të kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 7 mars 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës është në marrëdhënie të punës në Policinë e Kosovës si zyrtar policor që nga viti 2000, i angazhuar në detyra dhe obligime të ndryshme.

## ***Procedura penale***

13. Më 16 shkurt 2012, Prokuroria e EULEX-it filloi një hetim kundër parashtruesit të kërkesës me dyshimin se ai kishte kryer veprën penale të zbulimit të fshehtësisë zyrtare.
14. Më 16 janar 2013, Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe Prokuroria e EULEX-it nxori aktvendimin (PP. II-117/13) për pezullimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të mungesës së provave.

## ***Procedura disiplinore***

15. Më 18 qershor 2012, sipas shkresave të lëndës, njësitë profesionale të Policisë së Kosovës inicioi procedurë disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës për sjellje joprofesionale dhe zbulim të fshehtësisë zyrtare, për çka EULEX-i ka zhvilluar një hetim kundër tij.
16. Më 10 prill 2013, Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës (përmes vendimit 195KBD/13) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kundërvajtje disiplinore dhe i shqiptoi masën “degradim” dhe masën shtesë “transfer administrativ”. Në vendimin e tij, Komisioni i Brendshëm Disiplinor sqaroi se, *„I akuzuari Rreshter E.B., derisa kishte qenë kryerjen e detyrës zyrtare, në pozitën Udhëheqës i Njësisë së Hetimeve, në Policinë Kufitare, kishte zbuluar fshehtësi Zyrtare duke i transmetuar informata te personi K.L. dhe V.B. për kohën e bastisjes. Po ashtu ai është shoqëruar me personin K.L. dhe kishte mbajtur kontakt të vazhdueshëm me të duke ditur për të kaluarën e tyre kriminale, Me këtë i akuzuari ka kryer shkeljen disiplinore nga Kreu i II-të i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2008-MPB, lidhur me nenin 46 pika a & e të Ligjit për Policinë. Prandaj, Komisioni i Brendshëm Disiplinor bazuar në Udhëzimin Administrativ 06/2012, neni 58, pika 3, punonjësit të akuzuar i shqipton masën disiplinore”.*
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër vendimit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës në Komisionin Policor për Ankesa dhe Shpërblime, duke përmendur shkeljet procedurale, shkeljet e së drejtës materiale dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike.
18. Më 15 maj 2013, Komisioni i Policisë për Ankesa dhe Shpërblime (vendimi 67-KA-2013) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi në tërësi vendimin e shkallës së parë.
19. Më 22 maj 2013, Policia e Kosovës (me vendimin 07/1-01A/3051) e zbriti parashtruesin e kërkesës nga grada “Rreshter” në gradën “Zyrtar policor” dhe (me vendimin 07/1-01A/ 3052) e transferoi parashtruesin e kërkesës nga Departamenti i Policisë Kufitare-Njësi e Hetimit me seli në Prishtinë në Administratën Rajonale Veriore të Policisë Kufitare në Lluzhan. Në këtë mënyrë Policia e Kosovës ka respektuar vendimin (05/016/23171) të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës dhe vendimin (67-KA-2013) të Komisionit Policor për Ankesa dhe Shpërblime.

## Procedurat gjyqësore lidhur me kontestin e punës

20. Më 21 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër vendimit (05/016/23171) të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës dhe vendimit (67-KA-2013) të Komisionit të Policisë për Ankesa dhe Shpërblime (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke kërkuar anulimin e këtyre vendimeve dhe në këtë mënyrë rikthimin e gradës dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm si dhe diferencën e të ardhurave për periudhën e kontestuar.
21. Më 31 maj 2017, Gjykata Themelore (me aktgjykimin C. nr. 1468/13) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke anuluar si të kundërligjshme vendimet: nr. 07/1.01A 3051 të 22.05.2013, nr. 07/1-01A/3052 të 22.05.2012, nr. 195/KBD/2013 të 10.04.2013. viti dhe nr. 67-KA-2013 të 15.05.2013 të Policisë së Kosovës dhe (II) obligoi Policinë e Kosovës që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në pozitën e rreshterit në Policinë e Kosovës dhe për periudhën e kontestuar t'i paguajë atij diferencën në pagë në mes të pozitës së zyrtarit policor dhe rreshterit, si dhe kontributet pensionale dhe tatimin mbi të ardhurat.
22. Në arsyetimin e saj, Gjykata Themelore, ndër të tjera, theksoi se meqenëse procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës është pezulluar, nuk ka asnjë provë që parashtruesi i kërkesës ka zbuluar informata konfidenciale dhe akuza se parashtruesi i kërkesës është shoqëruar me persona me histori kriminale është e pabazuar.
23. Në një datë të pacaktuar, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës (në tekstin e mëtejme: MPB e Kosovës) parashtrroi ankesë kundër aktgjykimit (C. nr. 1468/13) të Gjykatës Themelore, duke konsideruar se e njëjta është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 12 janar 2021, Gjykata e Apelit (me aktgjykimin A.C. nr. 1139/2018) e refuzoi si të pabazuar ankesën e MPB-së së Kosovës dhe e vërtetoi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Themelore. (C. nr. 1468/13).
25. Në një datë të pacaktuar, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, MPB-ja e Kosovës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
26. Më 9 shkurt 2021, Policia e Kosovës (me urdhrin 07/1-01SAP-P/0929) filloi të ekzekutojë aktgjykimin (C. nr. 1468/13) e Gjykatës Themelore dhe aktgjykimin (A.C. nr. 1139/2018) të Gjykatës së Apelit.
27. Më 6 maj 2022, Gjykata Supreme me aktgjykimin Rev. nr. 70/2022 aprovoi si të bazuar revizionin e MPB-së së Kosovës, në atë mënyrë që ndryshoi aktgjykimet e shkallës së parë (C. nr. 1468/13) dhe të shkallës së dytë (A.C. nr. 1139/2018) dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e vendimeve: nr. 07/1.01A 3051, nr. 07/1-01A/3052, nr. 195/KBD/2013 dhe nr. 67-KA-2013 të Policisë së Kosovës.
28. Gjykata Supreme arsyetoi, ndër të tjera, se,

*“Për dallim nga përgjegjësia disiplinore për shkeljen e detyrave të punës dhe obligimeve paraqet një aspekt specifik të përgjegjësisë ligjore dhe aplikohet vetëm për personat fizik që janë në marrëdhënie të punës, Respektimi i rregullave të sjelljes të parapara për shërbimet e caktuara, në veçanti për*

*shërbimet që kanë specifika në punën e tyre, siç është Policia e Kosovës, është parakusht për një procesi të papenguar të punës dhe i ekzekutimit të suksesshëm të detyrave të punës të këtyre shërbimeve. Detyrat e punës të të punësuarve në polici janë të përcaktuara me ligj, mirëpo edhe me aktet adekuate nënligjore, në mënyrë të njëjtë është përcaktuar edhe forma e sjelljes së pjesëtarve të policisë dhe kufizimet që i kanë pjesëtarët e këtyre shërbimeve për shkak të specifikave të punës që kryejnë. Për dallim nga përgjegjësia penale, ku baza e përgjegjësisë qëndron në veprën e rrezikshme shoqërore të kryer, dhe ku qëllimi i sanksioneve penale është parandalimi i përgjithshëm dhe i veçantë, tek përgjegjësia disiplinore bazë për përgjegjësi paraqet shkelja e detyrës së punës, përkatësisht shkelja e detyrimit të sjelljes dhe respektimit të kufizimeve të cilat në rastin konkret kanë të bëjnë me pjesëtarët e policisë, ndërsa qëllimi i këtyre sanksioneve është që një sjellje e tillë të dënohet dhe të pengohet përsëritja e të njëjtës. Ajo që prokurori publik kompetent ka gjetur se nuk ka vend për ndjekje penale të paditësit këtu, nuk ka ndikim në përgjegjësinë disiplinore të paditësit këtu, si dhe në rezultatin e procedurës disiplinore. Përgjegjësia disiplinore është shumë më komplekse nga përgjegjësia penale, dhe mund të ekzistoj edhe atëherë kur nuk ka përgjegjësi penale, qoftë për shkak të rrezikshmërisë së pamjaftueshme shoqërore, qoftë për shkak të mungesës së fajësisë së kryesit ose provave të pamjaftueshme. Vendimi disiplinorë në rastin konkret bazohet në gjendjen faktike të vërtetuar në procedurën disiplinore. Fjala është për ato faktet e njëjta që janë vërtetuar edhe gjatë hetimit të prokurorit publik kompetent par kanë qenë të pamjaftueshme për të iniciuar dhe zhvilluar procedurë penale. Mirëpo, faktet e njëjta paraqesin bazë të mjaftueshme ligjore kur bëhet fjalë për përgjegjësinë disiplinore.”*

29. Më 21 korrik 2022, Policia e Kosovës (me urdhrin 07/1-01SAP-P/5713) filloi përmbarimin e aktgjykimit (Rev. nr. 70/2022) të Gjykatës Supreme të 6 majit 2022 dhe e shfuqizoi (me urdhrin 07/1-01SAP-P/0929) e Policisë së Kosovës të 9 shkurtit 2021.
30. Më 3 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës, kundër urdhrin (07/1-01SAP-P/5713) të Policisë së Kosovës të 21 korrikut 2022, parashtrroi ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës, duke kërkuar anulimin e të njëjtit.
31. Më 18 gusht 2022, Komisioni për Ankesa në Policinë e Kosovës (me vendimin 1332-KA-2022) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi në tërësi urdhrin (07/1-01SAP-P/5713) e Policisë së Kosovës. të 21 korrikut 2022.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme cenon të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 32, 46 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së.
33. Sa i përket pretendimit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës ka disa pretendime, përkatësisht:
  - (i) se Gjykata Supreme në këtë rast ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe jashtë ligjit, konkretisht nenit 211 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse në këtë rast nuk bëhet fjalë për një kontest pune, por një kontest në lidhje me uljen në detyrë dhe se vlera e kontestit në këtë rast nuk është specifikuar as nga parashtruesi i kërkesës dhe as nga gjykata, gjë që sipas parashtruesit të kërkesës nënkupton se vlera e kontestit është nën 3000 euro, përkatësisht vlera në bazë të së cilës nuk lejohet revizioni.

- (ii) se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008, procedura disiplinore në këtë rast është parashkruar sepse, „shkelja supozohet se ka ndodhur ne vitin 2011, ne anën tjetër vendimi përfundimtar administrativ është nxjerr me date 15.05.2013, qe do te thotë se kane kaluar me shume se dy vite nga koha e supozuar e shkeljes deri tek nxjerrja e vendimit përfundimtar”.
- (iii) se procedura disiplinore është zhvilluar në bazë të procedurës penale të pezulluar për shkak të mungesës së provave, e cila sipas parashtruesit të kërkesës paraqet mungesë të provave materiale në dosjen disiplinore.
- (iv) se parashtruesi i kërkesës nuk ka kryer shkelje disiplinore nga kapitulli i dytë, neni 5, paragrafi 7, përkatësisht se personi me të cilin parashtruesi i kërkesës shoqërohej (për të cilën arsye parashtruesit të kërkesës i ishte shqiptuar masa disiplinore) nuk ishte dënuar për një vepër penale “të rëndë”.
34. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës që i referohen shkeljeve të neneve 32, 46 të Kushtetutës dhe nenit 10 të DUDNJ-së, parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton pse janë shkelur këto dispozita, por vetëm i përmend ato në kërkesën e tij.
35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të,
- „ I. SHPALLET e pranueshme kërkesa e parashtruesve
- II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 3 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Kosovës.
- III. ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 70/2022 u datës 06.05.2022.
- IV. I KTTHEHET Gjykatës Supreme në rigjykim dhe rivendosje.“.

## Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

### Kushtetuta e Republikës së Kosovës

#### Kapitulli II

[Të drejtat dhe liritë themelore]

#### Neni 31

##### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

#### Neni 32

##### [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore

dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

#### **Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

#### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

##### **Neni 6**

##### **[E Drejta për një proces të rregullt]**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

#### **Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut**

##### **Neni 10**

Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

#### **Ligji për Procedurën Kontestimore**

[...]

#### **MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES**

##### **REVIZIONI**

##### **Neni 211**

211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykim.

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e

*ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro;*

*211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro*

*211.4 Përjashtimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar:*

*a) në kontestet për ushqim;*

*b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit;*

*c) në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

36. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

38. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

#### *Neni 47 (Kërkesa individuale)*

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

#### *Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)*

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*



Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

39. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë përcaktuar më lart, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 70/ 2022] të 6 majit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
40. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund ta shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kushtin që kërkesa nuk është qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) përcakton:
- “ Gjykata mund ta konsideroj kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
41. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin: [Kl04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin: [Kl175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendimet që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin: [Kl04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin [Kl175/20](#), cituar më lart, paragrafi 38).
43. Në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj

thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin: [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).

44. Gjykata vëren se thelbi i këtij rasti i referohet ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në Komisionin e Policisë për Ankesa dhe Shpërblime kundër vendimit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës, i cili e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e kundërvajtjes disiplinore dhe i shqiptoi masë disiplinore. Komisioni i Policisë për Ankesa dhe Shpërblime e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin se vendimi i kontestuar nuk bazohej në gabime faktike dhe materiale. Parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Themelore kundër vendimit të Komisionit të Policisë për Ankesa dhe Shpërblime. Gjykata Themelore e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, duke anuluar si të kundërligjshme vendimet e Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës dhe Komisionit Policor për Ankesa dhe Shpërblime dhe anuloi dënimin e shqiptuar disiplinor. Kundër vendimit të Gjykatës Themelore, Policia e Kosovës, përkatësisht MPB-ja parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e MPB-së si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se vendimi i kontestuar nuk ka karakteristika të shkeljes esenciale procedurale dhe se e drejta materiale është zbatuar drejt. MPB-ja parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të Gjykatës Themelore dhe të Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Gjykata Supreme aprovoi si të bazuar revizionin e MPB-së, në atë mënyrë që ndryshoi vendimin e Gjykatës Themelore dhe të Apelit dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e vendimit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës dhe Komisionit të Policisë për Ankesa dhe Shpërblime.
45. Gjykata rikujton se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në fakt i referohet parregullsisë së procesit gjyqësor, që ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, përkatësisht administrimit të gabuar të dëshmive nga Gjykata Supreme.
46. Gjykata, si çështje paraprake, përsërit se vlerësimi i procedurës në tërësi, përkatësisht nëse procedurat janë të drejta apo jo, përcaktohet duke i shqyrtuar ato në tërësinë e tyre (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Ankerl kundër Zvicrës](#), nr. 17748/91, aktgjykim i 23 tetorit 1996, paragrafi 38; dhe [Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë](#), nr. 38433/09, aktgjykim i 7 qershorit 2012, paragrafi 197). Prandaj, çdo mangësi në drejtësinë e procedurës, në kushte të caktuara, mund të korrigjohet në një fazë të mëvonshme, ose në të njëjtin nivel (shih, rastin e GJEDNJ-së: [Helle kundër Finlandës](#), nr. 157/1996/776/977, aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 54), ose nga një gjykatë më e lartë (shih, rastin e GJEDNJ-së: [Schuler Zraggen kundër Zvicrës](#), nr. 14518/89, aktgjykim i 24 qershorit 1993, paragrafi 52).

***(i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me lejueshmërinë e revizionit***

47. Gjykata në vijim rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se në këtë rast nuk lejohet revizioni, përkatësisht në bazë të nenit 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ai është i ndaluar për shkak se nuk ishte specifikuar kontesti i vlerës

sipas padisë dhe nuk është iniciuar kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, andaj në këtë rast, siç thotë ai, revizioni nuk ishte i lejuar.

48. Në vijim, lidhur me pretendimin e mësipërm të parashtruesit të kërkesës, Gjykata thekson se paragrafi 2 i nenit 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton: *“Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpapia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro”*.
49. Rrjedhimisht, në rastin konkret, Gjykata vëren se revizioni i paraqitur nga pala e interesuar ishte parashtruar në procedurën në të cilën vlera e objektit të kontestit pjesës së kontestuar të aktgjykimit ishte në shumë prej 4,231.92 euro. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se është përmbushur pragu minimal i kërkuar nga kjo dispozitë ligjore. Prandaj, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar sepse i përket kategorisë (ii) së pretendimeve të kategorizuara me *„mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*.

**(ii) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me „çështjet e faktit dhe ligjit“**

50. Duke iu referuar këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se ai ankohet se, (a) se procedura penale e zhvilluar kundër parashtruesit të kërkesës u pezullua për shkak të mungesës së provave dhe se nuk është e mundur të fillohet procedura disiplinore bazuar në këtë procedurë dhe prova, (b) nuk është vërtetuar se parashtruesi i kërkesës ka kryer kundërvajtje disiplinore të shoqërimit me persona të dënuar për vepra të rënda penale, sepse personi që vendoset në lidhje me të nuk është dënuar për një vepër të rëndë penale, por për një vepër të lehtë, dhe (c) se është aplikuar gabimisht Udhëzimi Administrativ nr. 15/2008 i Policisë së Kosovës, i cili përcakton se përgjegjësia disiplinore parashkruhet brenda 2 viteve pas kryerjes së shkeljes së pretenduar disiplinore.
51. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet pjesëve përkatëse të aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ku është arsyetuar: *„Për dallim nga përgjegjësia disiplinore për shkeljen e detyrave të punës dhe obligimeve paraqet një aspekt specifik të përgjegjësisë ligjore dhe aplikohet vetëm për personat fizik që janë në marrëdhënie të punës, Respektimi i rregullave të sjelljes të parapara për shërbimet e caktuara, në veçanti për shërbimet që kanë specifika në punën e tyre, siç është Policia e Kosovës, është parakusht për një procesi të papenguar të punës dhe i ekzekutimit të suksesshëm të detyrave të punës të këtyre shërbimeve. Detyrat e punës të të punësuarve në polici janë të përcaktuara me ligj, mirëpo edhe me aktet adekuate nënligjore, në mënyrë të njëjtë është përcaktuar edhe forma e sjelljes së pjesëtarve të policisë dhe kufizimet që i kanë pjesëtarët e këtyre shërbimeve për shkak të specifikave të punës që kryejnë. Për dallim nga përgjegjësia penale, ku baza e përgjegjësisë qëndron në veprën e rrezikshme shoqërore të kryer, dhe ku qëllimi i sanksioneve penale është parandalimi i përgjithshëm dhe i veçantë, tek përgjegjësia disiplinore bazë për përgjegjësi paraqet shkelja e detyrës së punës, përkatësisht shkelja e detyrimit të sjelljes dhe respektimit të kufizimeve të cilat në rastin konkret kanë të bëjnë me pjesëtarët e policisë, ndërsa qëllimi i këtyre sanksioneve është që një sjellje e tillë të dënohet dhe të pengohet përsëritja e të njëjtës. Ajo që prokurori publik kompetent ka gjetur se nuk ka vend për ndjekje penale të paditësit këtu, nuk ka ndikim në përgjegjësinë disiplinore të paditësit këtu, si dhe në rezultatin e procedurës disiplinore. Përgjegjësia disiplinore është shumë më komplekse nga përgjegjësia penale, dhe mund të ekzistoj edhe atëherë kur nuk ka përgjegjësi penale, qoftë për shkak të rrezikshmërisë së pamjaftueshme shoqërore, qoftë për shkak të mungesës së fajësisë së kryesit ose*

*provave të pamjaftueshme. Vendimi disiplinorë në rastin konkret bazohet në gjendjen faktike të vërtetuar në procedurën disiplinore. Fjala është për ato faktet e njëjta që janë vërtetuar edhe gjatë hetimit të prokurorit publik kompetent par kanë qenë të pamjaftueshme për të iniciuar dhe zhvilluar procedurë penale. Mirëpo, faktet e njëjta paraqesin bazë të mjaftueshme ligjore kur bëhet fjalë për përgjegjësinë disiplinore.”*

52. Gjykata Supreme në arsyetimin e saj, gjithashtu deklaroi „*e pakontestueshme është se paditësi ka qenë në raporte shoqërore me K. L., i cili për disa herë nga Policia e Kosovës është dyshuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, dhe se ky person dhe V. B, kanë marrë informatën në lidhje me planin operativ të policisë për t'i bastisur ata, si dhe për kohën kur do të bëhet bastisja.”*
53. Përveç kësaj, Gjykata vëren se shkelja disiplinore ka ndodhur në periudhën prej 27 majit 2011 deri më 4 nëntor 2011, dhe se procedura disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës ka filluar më 18 qershor 2012, ndërsa vendimi i shkallës së parë (195KBD/13 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor) është nxjerrë më 10 prill 2013, përkatësisht brenda periudhës 2-vjeçare të përmendur nga parashtruesi i kërkesës.
54. Gjykata vëren nga konkluzionet e Gjykatës Supreme se e njëjta iu përgjigj pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me çështjen nëse vendimet e kontestuara të autoriteteve të Policisë së Kosovës ishin marrë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata Supreme arsyetoi më tej dallimin ndërmjet përgjegjësisë penale dhe disiplinore dhe mënyrës së përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës thjesht nuk pajtohej me konkluzionet e Gjykatës Supreme lidhur me faktet e vërtetuara dhe të drejtën e aplikuar materiale dhe procedurale.
55. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës në të vërtetë e ka ndërtuar rastin e tij në bazë të ligjshmërisë dhe jo në bazë të kushtetutshmërisë. Gjykata rikujton se vetëm një pretendim i ngritur në nivelin e kushtetutshmërisë mund ta vë në lëvizje atë për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin juridik të brendshëm (shih, në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese, rasti: [KI76/21](#), Parashtrues: *Qemajl Babuni*, aktvendim i 10 nëntorit 2021, paragrafi 33).
56. Gjykata rikujton se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ndërlidhet me doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose të interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës [KI179/18](#), parashtruese: *Belgjjyzar Latifi*, aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; [KI49/19](#), parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A. „Adem Jashari“*, aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; [KI56/17](#), parashtruese: *Lumturije Murtezaj*, aktvendim për papranueshmëri i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe [KI154/17](#) dhe [KIO5/18](#), parashtrues: *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria më përgjegjësi të kufizuar “BARBAS”*, aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe rasti i fundit [KI76/21](#), parashtrues: *Qemajl Babuni*, aktvendim i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
57. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një

gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së: [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI49/19](#), cituar më lart, paragrafi 48 dhe [KI154/17](#) dhe [KIO5/18](#), cituar me lart, paragrafi 61, dhe rasti i fundit [KI76/21](#), parashtrues: *Qemajl Babuni*, aktvendim i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).

58. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe gjithashtu ajo e Gjykatës përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në ( shih, rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), nr. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; shih gjithashtu edhe rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KIO5/18](#), cituar me lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka „*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*“ në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar me “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të Konventës Evropiane (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, Pjesa IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e Mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës [KI154/17](#) dhe [KIO5/18](#), cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty, dhe rasti i fundit [KI76/21](#), parashtrues: *Qemajl Babuni*, aktvendim i 10 nëntorit 2021, paragrafi 36).
59. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se efektet e interpretimit dhe zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale janë të papajtueshme me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Për më tepër, nga konkluzionet e gjykatave të rregullta, shihet qartë se sa i përket rrethanave të rastit konkret, nuk bëhet fjalë as për „*aplikimin e ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*“, dhe as me konkluzione “*arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” nga ana e tyre.
60. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në lidhje me këtë pjesë të kërkesës, i përkasin kategorisë së parë (i) të pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla pasqyrojnë pretendimet në nivel të ligjshmërisë, sepse nuk janë të argumentuara në nivel të kushtetutshmërisë, prandaj, të njëjtat duhen të deklarohen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese.

### ***iii) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të neneve 32, 46 të Kushtetutës dhe nenin 10 të DUDNJ-së***

61. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 32, 46 të Kushtetutës dhe nenin 10 të DUDNJ-së, megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk jep një arsytim më të detajuar se si ka ardhur deri te shkelja e garancive kushtetuese. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se referimi i thjeshtë i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të

sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet [KI175/20](#) parashtruese e kërkesës: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 81, [KI166/20](#) parashtruese e kërkesës: *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 52, [KI 04/21](#) parashtruese e kërkesës: *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafët 38- 39).

62. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 32, 46 të Kushtetutës dhe nenin 10 të DUDNJ-së, kërkesa duhet të deklarohet si qartazi e pabazuar, sepse ato i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve „*të pambështetura apo të paarsyetuara*”.

## **Përfundim**

63. Shkurtimisht, Gjykata, duke marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konkluzionet e lartpërmendura, konstaton se: pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, që kanë të bëjnë me *lejueshmërinë e revizionit* hyjnë në kategorinë e dytë të pretendimeve me (ii) „*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*“ ndërsa çështjet e vërtetimit të fakteve dhe zbatimit të ligjit, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, prandaj në baza kushtetuese të njëjtat duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara, ndërsa pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve 32, 46 të Kushtetutës dhe nenit 10 të DUDNJ-së, i përkasin gjithashtu kategorisë së tretë të pretendimeve (iii) „*të pambështetura apo të paarsyetuara*, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht ka deklaruar dispozitën e Kushtetutës, pa arsyetuar se si ka ardhur deri te shkelja e neneve të përmendura.
64. Prandaj, kërkesa në tërësi, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 7 mars 2023, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani